



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.22, datë 02.04.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“IMPIANTI GJENERUES I ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW DHE VEPRAVE NDIHMËSE”, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN BITINCKË – BILISHT,
BASHKIA DEVOLL, QARKU KORÇË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar. me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Erni Solar” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit.

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Impianti gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprave ndihmëse”, me vendndodhje në Zonën Bitinckë – Bilisht, Bashkia Devoll, Qarku Korçë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Erni Solar” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Devoll.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT I TERRITORIT
ADELAJDARËKA



Nenshkruar më datë 29/06 / 2024